

Ekskluzive

Ekskluzive | U kthye me pistoletë pas sherrit në trafik, por përfundoi i rrahur – 26-vjeçari në Suharekë përfundon në pranga, dy të dyshuar për lëndimet e tij



Sinjali.com

13 Korrik 2026 08:46



Një konflikt i nisur në komunikacion ka eskaluar në një përleshje fizike dhe përdorim të armës në fshatin Duhël të Suharekës, ku një 26-vjeçar dyshohet se u kthye i armatosur për t'u përballur me dy personat me të cilët ishte fjalosur, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se bëhet fjalë për **Besart Graishtën**, 26 vjeçar ndërsa në incident janë përfshirë edhe **Safet Bujari**, 57 vjeçar dhe **Drilon Bujari**, 22 vjeçar.

Sipas informacioneve, gjithçka nisi pas një mosmarrëveshjeje në trafik. Pas fjalosjes, Besart Graishta ishte larguar nga vendi i ngjarjes, por pak më vonë ishte kthyer në qendër të fshatit me një pistoletë, duke e përshkallëzuar konfliktin.

Pas kthimit të tij ka shpërthyer një përleshje fizike mes palëve, gjatë së cilës lëndime trupore ka pësuar vetë Graishta, i cili më pas ka marrë trajtim mjekësor.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se gjatë intervistimit, i dyshuari e ka pranuar se posedonte armën dhe ka treguar se ajo ndodhej në shtëpinë e tij.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, Policia ka kryer bastisje në banesën e tij, ku ka sekuestruar një pistoletë të tipit "Zastava", një karikator dhe një fishek të kalibrit 6.35 mm.

Pas konsultimit me Prokurorin kujdestar, Besart Graishta është ndaluar për 48 orë nën dyshimin për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

Ndërkohë, Safet Bujari dhe Drilon Bujari janë proceduar penalisht për veprën "Lëndim i lehtë trupor" dhe janë liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

ekskluzive

sherr ne komunikacion Sinjali

Të tjera:



Ekskluzive | Krisma në dasmë në "Kështjella Pandora", Policia gjen mbi 140 gëzhoja – një i...

Ekskluzive



Ekskluzive | Sulmoi policët në Fushë Kosovë gjatë arrestimit për dhunë në familje, 28-...

Siguri



Ekskluzive | Nga mashtrim në vjedhje: Policia zbardh rastin vjedhjes së 190 eurove...

Ekskluzive



Ekskluzive | Konflikti për delet eskalon në Kamenicë: 66-vjeçari pretendon se u sulmua...

Ekskluzive




Ekskluzive | Krisma në mes të fejesës në Malishevë, Policia bastis shtëpinë dhe sekuestr...

Ekskluzive



Ekskluzive | Vetëplagosje me armë zjarri në Prishtinë, Policia gjen tek 20...

Ekskluzive



Ekskluzive | Kontesti për token përfundon me ndërhyrjen e Policisë në Gjakovë, 76-vjeçarit i...

Ekskluzive



Ekskluzive | Arsenal armësh e qindra fishekë zbulohen në një shtëpi të braktisur në veri –...

Ekskluzive

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera

